



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

**PROGRAMI I ZBATIMIT TË
STRATEGJISË SË ENERGJISË
2018-2020**

Prishtinë, korrik 2018

Përmbajtja

Shkurtesat	3
I. Përmbledhje ekzekutive	5
II. Hyrje.....	5
III. Metodologjia e përgatitjes.....	7
IV. Misioni, vizioni dhe objektivat.....	8
V. Masat dhe aktivitetet e PZSE	9
VI. Kostoja e vlerësuar për Zbatimin e PZSE 2018-2020.....	9
VII. Matrica e PZSE	11

Shkurtesat

ACER	Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë
AKEE	Agjencioni i Kosovës për Eficiencë të Energjisë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
EC	Komisioni Evropian
EE	Eficienca e Energjisë
EnCS	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike
ESCO	Kompanitë e Shërbimit të Energjisë
EU	Unioni Evropian
FIEK	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
FIM	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
HC	Hydrocentrale
HCV	Hydrocentrale të vogla
IDA	Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para Anëtarësimit
KDP	Komiteti Drejtues i Projektit
KE	Komisioni Evropian
KEDS	Ndërmarrja e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESCO	Ndërmarrja e Furnizimit të Energjisë Elektrike
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau (Banka Gjermane për Zhvillim)
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
kV	Kilovolt
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MCC	Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit
MED	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integritit Evropian
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MW	Megavat
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NO _x	Oksidi i Azotit
NQ	Ngrohtorja e Qytetit
NTCKR	Nën komiteti për Termocentralin Kosova e Re
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
NJIP	Njësia për Implementimin e Projektit

OS	Operatori i Sistemit
OSS	One Stop Shop
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
OST	Operatori i Sistemit të Tregut
OT	Operatori i Tregut
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
PKVEE	Plani Kombëtar i veprimt për Eficiencë të Energjisë
PZSE	Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë
QK	Qeveria e Kosovës
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
SNS/FDIL	Skema e Ndhimave Sociale/Familjet e Dëshmoreve dhe Invalidëve të Luftës
TC	Termocentral
TeR	Termet e Referencës
TIKA	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim
TM/TU	Tensioni i mesëm/Tensioni i ulët
UA	Udhëzimi Administrativ
UP	Universiteti Prishtinës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
USEA	Asociacioni për Energji i Shteteve të Bashkuara
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZBEK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

I. Përmbledhje ekzekutive

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020 është një dokument në të cilin paraqiten aktivitetet e detajuara për zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020, paraqet një listë prej 27 objektivash specifike dhe 97 aktiviteteve që parashihet të ndërmerren për zhvillimin e sektorit të energjisë deri në vitin 2020.

Projektet kyçe që parashihen të zhvillohen përgjatë kësaj periudhe konsiderohen: fillimi i ndërtimit të Termocentralit të ri TC Kosova e Re; fillimi i rehabilitimit të TC Kosova B; krijimi i tregut të përbashkët me Republikën e Shqipërisë si hap drejt integritit në tregun e EJJ, zgjerimi rrjeti të ngrrotores së qytetit të Prishtinës si dhe qytetit të Gjakovës, ndërmarrja e masave për reduktimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes si dhe një varg projektesh në fushën e efijencës së energjisë, burimeve të ripëtërtshme të energjisë si dhe atyre për mbrojtjen e mjedisit.

II. Hyrje

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2018-2020 (në tekstin e mëtejme PZSE 2018-2020) është dokument themelor trevjeçar për zhvillimin e sektorit të energjisë.

Roli, rëndësia, përmbajtja si dhe procedurat e përgatitjes së këtij dokumenti bazohen në Ligjin për Energji nr.05/L-081 dhe në Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

PZSE 2018-2020 mbështetet në politikat e përcaktuara në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026 të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 26 janar 2018.

Prioritet i lartë i Qeverisë është sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji për gjithë konsumatorët e vendit me cilësi sa më të lartë, me kosto sa më të përballueshme, duke pasur në konsideratë ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve si dhe përdorimin me efikasitet të energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripëtërtshme të energjisë. Strategjia e energjisë ka detajizuar politikat e arritjes së qëllimeve të përcaktuara. Krahas këtij prioriteti Qeveria e kushton rëndësi parësore zbatimit të detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit siç përcaktohet në Nenin 114 të saj.

PZSE 2018-2020 ka në konsideratë gjendjen jo të mirë të sektorit të energjisë që karakterizohet me:

- ngecjet në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike nga linjiti dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese;
- pamjaftueshmëria e kapaciteteve të gjenerimit për mbulimin e 'Pik-ut' në sezonin dimëror;
- mungesa e rezervave të fuqisë sekondare dhe terciare të sistemit si rrjedhojë e mungesës së gjeneratorëve fleksibil për shkak se 97% e prodhimit vendor bazohet në linjit;
- kapacitete të kufizuara të sistemeve të energjisë termike;
- mungesa e infrastrukturës së gazit natyror;
- humbjet e konsiderueshme teknike dhe komerciale të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes;
- mos menaxhimi i rrjedhave ndërkufitare nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit si pasojë e pengesave nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të Serbisë;
- mosshfrytëzim i duhur i potencialit të kursimit të energjisë;
- mosshfrytëzim i duhur i potencialit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- mungesa e tregut efektiv konkurrues në sektorin e energjisë elektrike.

Për rrjedhojë në këtë Program, në zbatim të masave të përcaktuara në Strategji, janë përcaktuar një varg projektesh për secilën masë që adreson problemet e sipër cekura, që konsiderohen të arritshme përgjatë periudhës trevjeçare 2018-2020.

Burimet e financimeve të aktiviteteve të përcaktuara në këtë Program janë të ndryshme përfshirë Buxhetin e Kosovës, investimet vetanake të ndërmarrjeve të energjisë, donacionet si dhe kreditë.

Disa nga aktivitetet e përcaktuara në masat për realizimin e objektivave të Strategjisë janë projekte të nisura në 2017 apo më herët, por që janë në vazhdim e sipër.

Pas miratimit në Qeveri të PZSE 2018-2020, fillon zbatimi i tij nga të gjitha palët përgjegjëse siç përcaktohet në Matricën e tij. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është mbikëqyrëse e zbatimit dhe përgatitjes së raporteve vjetore të monitorimit.

III. Metodologjia e përgatitjes

Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është themeluar Grupi Punues për hartimin e PZSE 2018-2020 në bazë të vendimit nr. 109 të datës 29.1.2018. Strukturimi i dokumentit dhe hartimi i tij është bërë në pajtim me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2018 të miratuar nga Qeveria.

Në këtë grup janë përfshirë ekspertët përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe akterët tjerë të lidhur me sektorin e energjisë si në vijim:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE),
- Zyra e Kryeministrit (ZKM);
- Ministria e Financave (MF);
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI);
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR); Ministria e Integritimit Evropian (MIE)
- Agjencia e Kosovës për Efiçencën e Energjisë;
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë);
- Operator i Sistemit, Transmetimit dhe Tregu (KOSTT);
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM);
- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK);
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS);
- Kompania për furnizim me Energji Elektrike (KESCO)
- Ngrohtorja Termokos dhe ajo e Gjakovës
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Mekanike;

Hartimi i dokumentit është bërë në punë ekipore.

Pas aprovimit të Matricës me të dhënat e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2018 të miratuar nga Qeveria, plotësuar edhe me indikatorë shtesë sipas udhëzimeve të ZKM-së, ka filluar procesi i identifikimit të projekteve në zbatim të secilit objektiv specifik. Janë zhvilluar takime grupore dhe individuale pune përgjatë gjithë procesit deri në kompletimin e Matricës. Anëtarët e Grupit punues janë përfshirë në koordinimin e aktiviteteve brenda entiteteve të tyre për të identifikuar këto aktivitete brenda fushë veprimtarisë së tyre. Ky proces është zhvilluar në një angazhim aktiv në baza ditore nën koordinimin e drejtuesit të ekipit, përfaqësues i MZHE-së.

Krahas draftimit të Matricës me të gjitha aktivitetet dhe projektet e identifikuara, duke përfshirë edhe bartësit e implementimit, afatin e implementimit, masën në përqindje të implementimit

etj, është punuar edhe në hartimit të kapitujve tjerë të Programit siç kërkohet nga Udhëzimi përkatës.

Pas miratimit të draftit nga Grupi punues dokumenti është dërguar për shqyrtim dhe miratim tek Kabineti i Ministrit.

Pas aprovimit nga Kabineti i Ministrit, dokumenti është dërguar në diskutim publik në tri versione (shqip, anglisht dhe serbisht). Krahas publikimit është dërguar një shkresë njoftuese për institucionet e Kosovës, donatorët dhe shoqërinë civile.

Pas trajtimit dhe adresimit të komenteve dokumenti finalizohet dhe dërgohet për opinion në MF dhe në MIE dhe më pas për shqyrtim dhe miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

IV. Misioni, vizioni dhe objektivat

PZSE 2018-2020 përgatitet në bazë të Ligjit për Energjinë. Në fushëveprimin e ligjit për energjinë përfshihen energjia elektrike, gazi natyror dhe energjia termike. Sipas këtij ligji definohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktimit të politikave dhe masave për burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe eficiencën e energjisë të cilat përcaktohen në planet kombëtare të veprimit, si dokumente zyrtare mandatore që miratohen nga Ministria përgjegjëse për energjinë, dhe që bazohen në objektivat strategjike të Strategjisë së Energjisë.

PZSE 2018-2020 udhëhiqet nga Vizioni, Misioni dhe objektivat e strategjisë së energjisë të përcaktuara në Strategjinë dhjetëvjeçare:

- a. **Vizioni:** *Strategjia e Energjisë synon krijimin e një sektori të zhvilluar të energjisë, i cili është i padëmshëm për mjedisin dhe shëndetin, që mbështetë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenien sociale në Kosovë, në kuadër të një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë*
- b. **Misioni:** *Misioni i Strategjisë së Energjisë është krijimi i kushteve për furnizim të besueshëm dhe të sigurt me energji, karshi kërkesës në rritje për energji, duke i zhvilluar kapacitetet prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse, dhe duke pasur në konsideratë diversifikimin e burimeve, shfrytëzimin eficient të energjisë, shfrytëzimin maksimal të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe mbrojtjen e mjedisit në të gjitha aktivitetet e sektorit.*
- c. **Objektivat:**
 1. *Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike;*
 2. *Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë;*
 3. *Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja;*
 4. *Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror;*
 5. *Plotësimi i caqeve dhe obligimeve në eficiencë të energjisë, burime të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit.*

V. Masat dhe aktivitetet e PZSE

PZSE përfshinë 27 masa përkatësisht objektiva specifike të parapara për t'u realizuar përgjatë periudhës 2018-2020. Në këto objektiva janë përfshirë edhe aktivitete për realizimin e objektivave specifike që planifikohen të fillojnë përgjatë kësaj periudhe përfundimi i të cilave parashihet të tejkalohet vitin 2020. Gjithashtu në aktivitetet e realizimit të objektivave specifike përfshihen edhe aktivitete të filluara më herët, por që janë ende në fazën e realizimit.

Për zbatimin e Objektivit të parë: *Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike, janë planifikuar 8 masa apo objektiva specifike dhe 33 aktivitete.*

Për Zbatimin e Objektivit të dytë: *Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë janë planifikuar 2 masa apo objektiva specifike dhe 15 aktivitete.*

Për zbatimin e objektivit 3. Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja, janë planifikuar 3 masa apo objektiva specifike dhe 5 aktivitete.

Për zbatimin e objektivit 4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror është parapara 1 masë apo objektiv specifik dhe 3 aktivitete.

Për zbatimin e objektivit 5. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve në efikasitet të energjisë, burime të ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit, janë parapara të realizohen 13 masa apo objektiva specifike dhe 41 aktivitete.

Pra janë planifikuar të zbatohen 97 aktivitete apo projekte. Aktivitetet janë të kategorive të ndryshme përfshirë masa të karakterit legjislativ, ndërtues, studimeve, promovues etj.

VI. Kostoja e vlerësuar për Zbatimin e PZSE 2018-2020

Vlerësimi i kostos për arritjen e objektivave strategjike për periudhën 2018-2020 është paraqitur në tabelën e mëposhtme dhe janë përfshirë të gjitha institucionet të cilat përmes investimeve financiare marrin pjesë në zbatimin e objektivave strategjike të parapara në PZSE 2018-2020. Një pjesë e këtyre investimeve janë investime vetanake nga ndërmarrjet e energjisë, investime nga BRK, investime private, kredi dhe donacione nga Qeveritë dhe institucionet e ndryshme financiare ndërkombëtare.

Vlerat e paraqitura janë në milion €. Në këtë listë janë paraqitur: (i) projektet e filluara para periudhës 2018-2020 e që parashihet të përfundojnë në këtë periudhë; (ii) projektet që fillojnë në periudhën 2018-2020 dhe që përfundojnë në këtë periudhë dhe (iii) projektet që fillojnë në periudhën 2018-2020 dhe përfundojnë pas kësaj periudhe.

Objektivat Strategjike	Objektivat Specifike	BRK	GIZ	KfW	USAID	KE	BB	KEK	KEDS	KOSTT	Inv.pri vate	UP	Donat or tjerë	Term okos	Komu na Pr	Qeveria Amerikane	Qeveria Gjerm /Lukse.	WBIF/BERZH	IDA	SIDA	
Objektiv 1	Objektiv specifik 1	5.78																			
	Objektiv specifik 2	38				38		42													
	Objektiv specifik 3	150						1.6													
	Objektiv specifik 4								108												
	Objektiv specifik 5										0.4	1									
	Objektiv specifik 6	13.5																			
	Objektiv specifik 7							0.1													
	Objektiv specifik 8					1.5															
Nën Totali		207.28				39.5		43.7	108			0.4	1								399.98
Objektiv 2	Objektiv specifik 1									2.005											
	Objektiv specifik 2									2.425											
Nën Totali										4.43											4.43
Objektiv 3	Objektiv specifik 1					8.3								0.25	0.25	9	10				
	Objektiv specifik 2					12						2.5									
	Objektiv specifik 3																	2			
Nën Totali						20.3							2.5	0.25	0.25	9	10	2			44.3
Objektiv 4	Objektiv specifik 1																	3.8			
Nën Totali																		3.8			3.8
Objektiv 5	Objektiv specifik 1	0.75																			
	Objektiv specifik 2	2.5				10	6														
	Objektiv specifik 3		GIZ																		
	Objektiv specifik 4					KE															
	Objektiv specifik 5																	BERZH/ WBIF			
	Objektiv specifik 6																				
	Objektiv specifik 7			7.5															11		
	Objektiv specifik 8					0.35												BERZH			
	Objektiv specifik 9										359.7										
	Objektiv specifik 10	BRK																			
	Objektiv specifik 11	BRK																			
	Objektiv specifik 12	MMPH																			SIDA
	Objektiv specifik 13					1.5															
Nën Totali		3.25	7.5			11.85	6				359.7								11		399.25
TOTALI																			851.73		

<p>Kërkohej financim: d. Studimi i Sizmikes e. Studimi i mjeteve shpërthyes f. Studimi i Topografisë h. Studimi i Gjeologjisë, Gjeoteknikës dhe Kontaminimit i. Studimi Hulumtimeve për pengesat nëntokësore j. Studimi i Ujit të papërpunuar</p>	<p>Për tu përcaktuar</p>					
<p>4. Hartimi i TeR, tenderimi dhe kontraktimi i inxhinierëve të pavarur</p>	<p>TM1 2018 TM4 2019</p>	<p>4 mil. €</p>	<p>BRK</p>	<p>KDP/NJIP</p>	<p>KDP/NJIP</p>	<p>Qeveria e Kosovës</p>
<p>5. Plotësimi me staf përkatës i njësisë Implementuese të Projektit sipas vendimit të KDP-së</p>	<p>TM1 2018 TM4 2019</p>	<p>1.05 mil. €</p>	<p>BRK</p>	<p>KDP/NJIP</p>	<p>KDP/NJIP</p>	<p>Qeveria e Kosovës</p>
<p>6. Pjesëmarrja/realizimi i konferencave informuese për mundësin e përfshirjes së NVM-ve në projektet zhvillimore energjetike:</p> <p>a) Pjesëmarrja e MZHE në Konferencën informuese “Ditët e biznesit të vogël” të cilën e organizon MTI për sektorin e NVM-ve – Tema nga MZHE: “Informimi i NVM-ve për mundësitë e përfshirjes së tyre gjatë procesit ndërtimit të TC Kosova e Re”</p> <p>b) Realizimi i konferencës me temën “Investimet strategjike në sektorin e energjisë – Mundësitë e përfshirjes dhe participimi aktiv i NVM-ve në këto projekte”</p>	<p>a) TM3 2018 b) TM2 2019</p>	<p>a) 0 b) 0.03 mil. €</p>	<p>MZHE MTI</p>	<p>MZHE MTI</p>	<p>MZHE</p>	<p>Informimi i NVM-ve për mundësitë e përfshirjes së tyre në projektin e TC Kosova e Re</p>

Objektivi specifik 1.2.	Indikator (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza 2018	Caku 2020	Caku 2021
Realizimi i remonteve kapitale në TC Kosova A, TC Kosova B dhe instalimi i elektrofiltrave në TC Kosova B	1. Remonti kapital i njësisë A3 të TC Kosova A, i realizuar; 2. Remonti kapital i njësisë B2 të TC Kosova B, i realizuar; 3. Remonti kapital i njësisë B1 të TC Kosova B, i realizuar; 4. Elektrofiltrat në TC Kosova B, të instaluar 5.Reduktimin i NOx në TC Kosova B			1. 100 % 2. 100% 3. 0 % 4. 0 % 5. 0 %	3. 100 % 4. 20 % 5. 20 %	4. 100 % 5. 100 %
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Remonti kapital i Njësisë A3 të TC Kosova A	TM2 - TM3 2018	12 mil. €	KEK	KEK	KEK	Remonti kapital i Njësisë A3 të TC Kosova A i realizuar
2. Remonti kapital i Njësisë B2 të TC Kosova B	TM2 – TM3 2018	15 mil. €	KEK	KEK	KEK	Remonti kapital i Njësisë B2 të TC Kosova B i realizuar
3. Remonti kapital i Njësisë B1 të TC Kosova B	TM2 – TM3 2019	15 mil. €	KEK	KEK	KEK	Remonti kapital i Njësisë B1 të TC Kosova B i realizuar
4. Instalimi i Elektrofiltrave në TC Kosova B	TM3 2020 TM3 2021	42 mil. €	50 % Komisioni Evropian, 50 % Qeveria e Kosovës	KEK	MZHE	Instalimi i Elektrofiltrave i realizuar
5. Investimet në reduktimin e NOx në TC Kosova B	TM3 2020 TM3 2021	34 mil. €	50 % Komisioni Evropian, 50 % Qeveria e Kosovës	KEK	MZHE	Reduktimi i NOx i realizuar

Objektivi specifik 1.3.	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza 2018	Caku 2020	Caku 2023
Mihja e Re “Sibovci Jugor”	1. Plani i detajuar për hapjen e mihjes së re, i përgatitur;			20%	100%	100%
	2. Miniera e re e linjtit e gatshme për eksploitim			0%	10%	100%
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Përgatitja e planit të detajuar për hapjen e mihjes së re	TM3 2017 TM2 2018	1.6 mil. €	KEK	KEK	MZHE	Dokumenti final i planit të detajuar
2. Hapja e mihjes së re	TM2 2019 TM1 2023	285 mil. €	Qeveria e Kosovës ¹	MZHE	KEK	Mihja e re e gatshme për eksploitim
Objektivi specifik 1.4.	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza 2018	Caku 2020	Caku 2025
Reduktimi i humbjeve teknike dhe komerciale në rrjetin e shpërndarjes	Humbjet komerciale dhe Humbjet teknike			16.9 %	16.9 %	12 % ⁴
Reduktimi i humbjeve teknike deri në 9.5% deri në vitin 2026 në rrjetin e shpërndarjes ²³						
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Ndërrimi i njësoreve mekanik me njësojë digjital;	TM1 2018 TM4 2025 (Të përfshira vetëm vitet 2018-2020)	19.2 mil. €	KEDS	KEDS	ZRRE, Komunat, MMPH, MTI, KESCO	Reduktimi dhe parandalimi i humbjeve komerciale; Eliminimi i
2. Zhvendosja e njësoreve (MMO);						

¹ Kostoja për hapjen e Minerës së re të thëngjillit nuk është siguruar

² Shënim: Kostoja e projekteve është sipas planifikimit të KEDS të dorëzuar për aprovim në ZRRE dhe i cili mund të ndryshoj varësisht nga vlerësimi/aprovimi i ZRRE-së.

³ Shënim: Numri i njësoreve i planifikuar për t'u zëvendësuar është sipas planifikimit të KEDS të dorëzuar për aprovim në ZRRE dhe i cili mund të ndryshoj nga 30-50% varësisht nga vlerësimi/aprovimi i ZRRE-së.

⁴ Shënim: Caku për reduktimin e humbjeve në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes do të konsiderohet final në momentin kur të aprovohet nga ZRRE si autoritet autonom dhe duhet të janë në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026.

<p>3. Implementimi i njehsorëve automatik inteligjent;</p> <p>Për vitet 2018-2020 numri i pritshëm për ndërrimin e njehsorëve arrin rreth 161 247** mijë njehsorë</p>					<p>gabimeve të mundshme në lexim; Zvogëlim i mundësisë së keqpërdorimit të njehsorëve</p>
<p>4. Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes duke u fokusuar në kalimin në nivel të tensionit 20 kV, respektivisht eliminimin gradual të tensionit 35 kV dhe 10 kV, në përputhshmëri me rregullat e ZRRE-së dhe standardet ndërkombëtare;</p> <p>5. Zvogëlimi i linjave të gjata radiale duke vendosur stabilimente shpërndarëse nëpër degëzime të daljeve 10kV;</p>	<p>TM1 2018 TM4 2025 (Të përfshira vetëm vitet 2018-2020)</p>	<p>23.6 mil. €</p>	<p>KEDS</p>	<p>KEDS</p>	<p>Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe rënieve të tensionit; Furnizimi i pandërprere me energji elektrike dhe rritja e cilësisë së furnizimit; Lokalizimi i prishjeve</p>
<p>6. Ndërtimi i nënstacioneve të reja të rrjetit të TM/TU;</p> <p>7. Ndërtimi i rrjetit të ri të tensionit të ultë;</p> <p>8. Rehabilitimi i rrjetit ekzistues;</p> <p>9. Furnizimi alternativ i daljeve 10kV, gjegjësisht nënstacioneve ekzistuese nga ana sekondare;</p> <p>Në kuadër të këtij aktiviteti, gjatë viteve 2017-2019, pritet të vendosen dhe/apo zëvendësohen rreth 200 transformatorë për vit</p>	<p>TM1 2018 TM4 2025 (Të përfshira vetëm vitet 2018-2020)</p>	<p>40.1 mil. €</p>	<p>KEDS</p>	<p>KEDS</p>	<p>Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale; Zvogëlimi i rënieve të tensionit; Furnizimi i pandërprere me energji elektrike dhe rritja e cilësisë së furnizimit; Zvogëlimi i mbingarkesave; Rehabilitimi dhe modernizimi i rrjetit të</p>

						shpërndarjes
<p>10. Implementimi i sistemit SCADA për kontrollin, komunikimin dhe mbikëqyrjen e te dhënave;</p> <p>11. Implementimi i softuerëve për kalimin nga rrjeti i vjetër në rrjetin e mençur</p> <p>12. Implementimin e kërkesave të reja me hapjen e tregut konkurrues;</p> <p>Plotësimi i nevojave për makineri dhe mjete të punës, me qëllim të lehtësimit të operimit dhe shkurtimit të kohës së reagimit ndaj prishjeve</p>	<p>TM1 2018 TM4 2025 (Të përfshira vetëm vitet 2018-2020)</p>	<p>25.2 mil. €</p>	<p>KEDS</p>	<p>KEDS</p>	<p>ZRRE, KOSTT, KESCO, MED, MTI</p>	<p>Zvogëlimi i orëve të ndërprera të paplanifikuara dhe izolimi i ndërprerjeve; Modernizimi i rrjetit; Qasja e lehtë në të dhënat energjetike të sistemit të shpërndarjes; Rritja e cilësisë operative</p>
Objektivi specifik 1.5.	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza 2018	Caku 2020	Caku 2025
<p>Reforma Programore Universitare në shkencat teknike të fushëveprimtarisë së energjisë</p>	<p>1. Programet e reja për studimet në FIEK dhe FIM, të hartuara;</p> <p>2. Përkrahja financiare e studentëve me bursa, e realizuar;</p> <p>3. Kontraktimi i ligjërueseve kredibil ndërkombëtar, i realizuar;</p> <p>4. Kompletimi i laboratorëve të FIM dhe FIEK, i realizuar.</p>			<p>10%</p>	<p>50%</p>	<p>100%</p>
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
<p>1. Zhvillimi i programeve dhe praktikave të reja mësimore, konform kërkesave të reja të tregut të punës për inxhinierët e rinj, bazuar në modelet më të mra në vendet e BE-së</p>	<p>TM3 2018 TM4 2020</p>	<p>0.2 mil. €</p>	<p>Donatorët</p>	<p>UP FIEK FIM</p>	<p>Ministria e Arsimit MZHE</p>	<p>Programi i ri në përputhje me kërkesat e reja të tregut të energjisë</p>
<p>2. Mbështetja me bursa për studentët e dalluar që ndjekin studime në ato programme në</p>	<p>TM3 2019 TM4 2021</p>	<p>0.36 mil. €</p>	<p>Donatorët BRK</p>	<p>UP FIEK</p>	<p>Ministria e Arsimit</p>	<p>Mbështetje financiare për 20</p>

Fakultetit i inxhinierës Elektrike dhe kompjuterike - drejtimi i Elektronergjetikes: niveli Bachellor, Master dhe Doktoratur					MZHE	student të Bechelor, 20 student të master dhe 10 në studime të doktoraturës të drejtimit të elektroenergjetikës
3. Mbështetja për kontraktimin e ligjeruesve kredibilë ndërkombëtarë, për lëndët e përcaktuara në ato programme	TM3 2020 TM4 2025	0.75 mil. €	Donatorët BRK	UP FIEK	Ministria e Arsimit MZHE	Ngritja dhe zhvillimi pesë vjeçar i kuadrove të reja të drejtimit të elektroenergjetikës
4. Përkrahja e Universitetit të Prishtinës "HASAN PRISHTINA", Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe atë të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: a) Përkrahja në kompletimin e laboratorit në fushën e Termoenergjetikës dhe Energjisë së Ripërtërishme; Realizimi i pilot projekteve në fushën e BRE-ve (instalimi i PV, ngritja e parkut të gjelbër, promovimi i një objekti model me konsum të ulët të energjisë) b) Përkrahja në kompletimin e laboratorëve në drejtimin e elektroenergjetikës	TM3 2018 TM4-2019	a) 1 mil. € b) 1.5 mil €	Donatorët (TIKA, GIZ, Zyra e BE-së, USAID-i – EMPOWER, MCC, BRK, etj.)	FIM FIEK	UP, MZHE, Ministria e Arsimit, MF	Laboratorët e kompletuar me pajisjet e nevojshme për FIM dhe FIEK
Objektivi specifik 1.6	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza 2018	Caku 2020	Caku 2026

Programi i Mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë	Subvencionimi i energjisë elektrike për familjet në Asistence Sociale (22,700) dhe disa familjeve/kategorive të dala nga lufta (11,100)			100%	100%	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Hartimi dhe përgatitja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes MPMS-s dhe KEDS-KESCO	TM1 2018 TM4 2020	13.5 mil. €	Buxheti i Kosovës (MF-MPMS)	MPMS	MZHE,MF,KEDS-KESCO	Subvencionimi i energjisë elektrike për të gjitha familjet në SNS dhe FDIL
Objektivi specifik 1.7	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza 2018	Caku 2020	Caku 2026
Trajtimi i komuniteteve të prekura nga aktivitetet energjetike (TC-të, Ngrohtoret etj.)	Investimet në komunitet nga KEK			100 %		
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
1. Projekte direkte për komunitetin, të cilat aprovoohen nga Kuvendi Komunal i Obiliqit	TM2 2018 TM4 2018	0.1 mil. €	KEK	KEK	Komuna Obiliq	Rritja e cilësisë së shërbimeve publike
2. Realizimi i projekteve zhvillimore për komunitetin nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit nga investitori TC Kosova e Re <i>(Investimet për komunitetin për vitet 2019-2020, 2 mil. €)</i>	TM1 2019 TM4 2020	TM1 2019 TM4 2024 10 mil. €	Investitori privat TC Kosova e Re	Investitori privat TC Kosova e Re	Komuna Obiliq MMPH	Përmirësimi i kushteve të jetesës së komunitetit të atakuar nga zhvillimet energjetike
Objektivi specifik 1.8	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza 2018	Caku 2020	Caku 2026
Studimi gjithë përfshirës për një periudhë deri në 2050 për sektorin e energjisë	Studimet e realizuara			0 %	100 %	

Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti
Realizimi i studimeve gjithëpërfshirëse për sektorin e energjisë për periudhën deri në vitin 2050	TM1 2019 TM4 2020	1.5 mil. €	MZHE Donatorët (KE)	MZHE	MF, MMPH, MTI, MMPS, MBPZHR KEK, KOSTT, KESKO, Ngrohtoret	Studimet e realizuara ku do të përfshihen 10 komponente në përputhje me TeR
Objektivi Strategjik #2: INTEGRIMI NË TREGUN RAJONAL TË ENERGJISË						
Objektivi specifik 2.1.	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit			Baza 2018	Caku 2020	Caku 2026
Zbatimi i “masave të buta” sipas udhërrëfyesit të SKE-së	<ul style="list-style-type: none"> • Anëtarësimi i ZRRE në ACER me status të vëzhguesit; • Licencimi i Furnizuesit të Mundësisë së Fundit; • Eliminimi i rregullimit të çmimit të prodhimit • Implementimi i rregulloreve të rjetit Trans Evropian • Alokimi regjional i kapaciteteve interkonektive; • Llogaritja e koordinuar e kapaciteteve interkonektive; • Shturja pronësore e KOSTT; • Shturja legale the funksionale e OSSH • Pavarësia e zyrës së rregullatorit të energjisë; • Rritja e efektivitetit të autoriteteve administrative - konkurrenca dhe ndihma shtetërore; • 			<ul style="list-style-type: none"> • 100 % • 100 % • 10 % • 100 % • 100 % • 100 % • 100% • 100% • 100 % 	<ul style="list-style-type: none"> • 100 % 	
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Inst. udhëheqës	Inst. mbështetës	Produkti

1. Aplikimi për anëtarësim - Anëtarësimi i ZRrE në ACER	TM3 2018	5000 €	ZRRE	ZRRE	ZRRE	Anëtarësimi i ZRrE në ACER
2. Emërimi dhe licencimi i Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	TM4 2018	0	/	ZRRE	USAID-Repower	Caktimi i Furnizuesit të Mundësisë së Fundit me akt të veçantë nga ZRRE
3. Sigurimi i likuiditetit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike me masa të përshtatshme rregullatore siç janë rishikimet e kontratave, shkarkimet e kapaciteteve, impiantet virtuale të energjisë etj.	TM2 2018 TM4 2019	0	/	ZRRE	KOSTT	Arritje e zbatueshmërisë së konkurrencës
4. Mundësia ligjore për operatorët e sistemit të transmisionit për të marrë shërbime balancuese nga të gjithë operatorët kombëtar dhe në perspektivën e një tregu rajonal nën kushtet konkurruese	TM4 2021	2 mil. €	ZRRE	KOSTT	ZRRE	Plotësimi i mungesave të rezervave nacionale për balancimin e sistemit
5. Miratimi i një modeli të balancimi të bazuar në treg duke lejuar shkëmbim jo diskriminues ndërkufitar të Kosovës të shërbimeve të balancuara - Krijimi i një tregu kombëtar balancues funksional	TM1 2020 TM4 2020	0	KOSTT	KOSTT	ZRRE	Modeli i balancimi, i miratuar
6. Prezantimi i një procesi të koordinuar të llogaritjes së kapacitetit për alokimin e kapaciteteve një ditë-para (day ahead) bazuar në një parashikim të koordinuar të kongestionit	TM1 2018 TM4 2018	Financuar nga EnCS	/	KOSTT	ZRRE	
7. Certifikimi Operatori i Sistemit të Transmisionit në linjë me Paketën e Tretë të Energjisë	TM1 2018 TM4 2018	0	/	KOSTT	ZRRE EnCS	Operatori i Sistemit të Transmisionit, i certifikuar

<p>8. Rritja e efektivitetit të autoriteteve administrative - konkurrenca dhe ndihma shtetërore;</p> <p>a) Rekrutimi i pesë zyrtarëve në kuadër të Departamentit të Ndhmës Shtetërore/MF;</p> <p>b) Hartimi i Rregullores për Procedurat e Njoftimit në përputhje me Ligjin për ndihmën shtetërore; Rishikimi i Rregullores Nr.1/2013 për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore;</p> <p>c) Emërimi i Komisionit të Ndhmës Shtetërore (KNSH) nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;</p> <p>d) Krijimi i inventarit për ndihmën shtetërore, duke përfshirë notifikimin për ZRRE dhe MZHE;</p>	<p>TM1 2018 TM4 2020</p>	<p>/</p>	<p>MF/Donatorët</p>	<p>MF</p>	<p>MF KE</p>	<p>Rekrutimi i pesë zyrtarëve në kuadër të DNSH; Miratimi i legjislatorit sekondar; KNSH, funksional; Inventari për Ndhmë shtetërore i krijuar</p>
